

METODOLOGJIA E VLERAVE REFERUESE NË RAST SE TË DHËNAT E MATJES JANË PËRKOHËSISHT TË PADISPONUESHME DHE TË PAARRITSHME PËR PERIUDHEN 15 SHKURT – 31 DHJETOR TË VITIT 2022

a. Në rastet kur Furnizuesi merr dijeni nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarritshme për një periudhë më të gjatë se një muaj (matësi është i dëmtuar, matësi është jashtë kushtit teknik apo mungon aksesit në të dhënat e matjes), faturimi i energjisë elektrike do të bëhet me vlerë referuese. Kjo vlerë do të përlogarit bazuar në të njëjtin konsum të muajit respektiv të vitit të mëparshëm. Periudha e faturimit sipas këtyre vlerave referuese nuk mund të zgjasë me shumë se tre muaj.

b. Për kontratat e furnizimit me energji elektrike që nuk kanë faturime të viteve të mëparshme të konsumit me matje të energjisë elektrike, faturimi me vlera referuese të bëhet bazuar në mesataren e konsumit me matje të energjisë elektrike, të regjistruar gjatë vitit të fundit në sistemin e faturimit.

c. Për kontratat e furnizimit me energji elektrike me mates të energjisë elektrike të instaluar në boks kolektiv, përjashtohet faturimi i energjisë elektrike me vlerë referuese si pasojë e mungesës së aksesit në të dhënat e matjes.

ç. Për faturimet me vlerë referuese si pasojë e mungesës së aksesit në të dhënat e matjes, në momentin e leximit të të dhënave të matjes, Furnizuesi do të axhustojë në faturën pasardhëse të energjisë elektrike, diferencën ndërmjet sasisë së energjisë së faturuar me vlerë referuese dhe sasisë së energjisë së konsumuar referuar të dhënave të matjes.

d. Konsumatorët që nuk kanë referencë asnjë muaj të leximit të matjes së energjisë elektrike do të faturohen me vlerë referuese 0 kWh.

dh. Konsumatorët që kanë lexim me matje të energjisë elektrike në një periudhë nga 1 (një) deri në 11 (njëmbëdhjetë) muaj, do të faturohen me vlerë referuese bazuar në vlerën mesatare për muajt e matur të konsumit të energjisë elektrike.